

UDHËZIM
Nr. 43, datë 9.2.2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 24.9.2012, “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RUAJTJEN E SIGURISË SË TË DHËNAVE
PERSONALE TË PËRPUNUARA NGA KONTROLLUESIT E MËDHENJ”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të shkronjës “F”, pika 1, e nenit 31 dhe nenit 27, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 21, datë 24.9.2012, “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kapitullin I, në pikën 13, shtohet paragrafi si vijon:

“Ruajtja e të dhënave në këto shërbime bëhet në përputhje me qëllimin e mbledhjes së tyre.

Të dhënat mbahen në tejkallim të afatit vetëm pas informimit paraprak të subjektit dhe dhënies së pëlqimit prej tij në mënyrë të qartë, si dhe duke i dhënë/rezervuar të drejtën për të refuzuar.

Procesi i shkatërrimit të të dhënave të realizohet në mënyrë të pakthyeshme.

Të dhënat personale që përpunohen me anë të këtyre shërbimeve nuk duhet të transferohen jashtë territoreve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, pa marrë më parë opinionin e autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

2. Në kapitullin III, pas shkronjës “c”, të pikës 22, shtohet shkronja “ç” më këtë përmbajtje:

“ç) Në rast se nuk është përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, i cili rregullon përpunimin e veçantë të të dhënave, periudha e mbajtjes së të dhënave përcaktohet nga çdo kontrollues në përputhje me qëllimin e mbledhjes së të dhënave. Për çdo ndryshim në afatin e ruajtjes, kontrolluesi rivlerëson kohën e ruajtjes, si dhe njofton subjektin e të dhënave.

Pas përfundimit të periudhës së mbajtjes së të dhënave, subjekti i të dhënave hiqet në mënyrë të pakthyeshme nga të gjitha sistemet aktive të përpunimit të të dhënave, automatike, manuale apo të anonimizuara.”.

3. Fjalët “Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” zëvendësohen me “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi